

PËRMBLEDHJE DOKTORATASH-PΕΡΙΛΗΨΗ ΔΙΔΑΚΤΟΡΙΚΩΝ

Αριστοτέλης Η. Σπύρου, *ΤΟ ΕΛΛΗΝΙΚΟ ΓΛΩΣΣΙΚΟ ΙΔΙΩΜΑ ΤΗΣ ΠΕΡΙΟΧΗΣ ΔΕΛΒΙΝΟΥ ΚΑΙ ΑΓΙΩΝ ΣΑΡΑΝΤΑ*, διδακτορική διατριβή, Εθνικό και Καποδιστριακό Πανεπιστήμιο Αθηνών, Φιλοσοφική Σχολή, Τμήμα Φιλολογίας, Τομέας Γλωσσολογίας, Αθήνα 2000, 326 σελ. [Aristotel I. Spiro, *Të folmet greke të krahinës së Delvinës dhe Sarandës*, punim doktrate, Universiteti Kombëtar «Kapodistria» i Athinës, Fakulteti Filozofik, Dega e Filologjisë, Seksioni i Gjuhësisë, Athinë 2000, 326 faqe].

Mbrojtur në verën e vitit 2000 në Universitetin e Athinës

(PËRMBLEDHJE)

Objekt i studimit janë të folmet greke të krahinës së Delvinës dhe Sarandës (FDS). Ky është punimi i parë gjithëpërfshirës për këto të folme. Të folmet studiohen në të gjitha nivelet, në fonetikë-fonologji, gramatikë (morfoloji, sintaksë, fjalëformim) dhe në leksik. Fokusi i gjerë i objektit ka imponuar në njëfarë mase edhe metodën e studimit.

Siç theksohet edhe në Hyrje (f. 3-7) në punim zbatohet përshkrimi dhe analiza sinkronike, pa ndjekur në mënyrë rigoroze një formë standarde studimi. Termat e përdorur janë, në përgjithësi të pranuar në gjuhësinë e përgjithshme (*strukturë gjuhësore, sitem gjuhësor, nyjetim i dyfishtë, përzgjedhje, ekonomi gjuhësore, fonemë, kryefonemë, asnjansim, opozicion, morfemë, klasa paradigmatiske* etj.)

Në sintaksë zbatohet një metodë më tradicionale dhe e tillë është edhe terminologjia përkatëse. Një rol përcaktues luan gjatë gjithë studimit koncepti i *ndjenjës gjuhësore*. Pikë kryesore referimi ka shërbyer përvoja e vetë autorit, i cili ka jetuar në mjedisin ligjërimor dialektor të krahinës si folës aktiv për rreth njëzet vjet. Por studimi mbështetet kryesisht në një korpus të pasur tekstesh gojore, të regjistruara nga autori në mjedisin e drejtpërdrejtë dialektor gjatë viteve 1992-1994.

Autori i studion të folmet si pjesë të diasistemit gjuhësor grek. Tipar dialektor përbën sipas tij jo vetëm prania e një dukurie, por edhe mungesa e saj, si dhe denduria e pranisë së dukurisë dialektore.

Punimi përbëhet nga pesë krerë.

Në kreun e parë (f. 8-15) përshkruhet pozicioni gjeografik i krahinës së Delvinës dhe Sarandës si dhe bëhet një vështrim i shkurtër historik i trevës dialektore, duke u mëshuar fakteve sociolinguistike.

Në kreun e dytë (f. 16-83) përshkruhet sistemi fonologjik-fonetik i të folmeve.

Në kreun e tretë (f. 84-165) skicohet struktura gramatikore e FDS.

Në kreun e katërt (f. 166-179) përshkruhen morfemat fjalëformuese (prejardhja dhe përbërja).

Në kreun e pestë (f. 180-206) përshkruhet struktura e fjalorit, duke e vënë theksin tek përzgjedhjet më karakteristike.

Në fund të pjesës «teorike» formulohen përfundimet përkatëse (f. 207-210) dhe menjëherë pas përfundimeve është shtuar fjalësi (f. 211-281), që përfshin korpusin e fjalëve, që rezultoi nga kërkimi i drejtpërdrejtë në terren. Mandej jepen të transkriptuara disa tekste përfaqësuese dialektore (f. 283-305), disa tabela me të dhëna demografike (f. 306-309) dhe me emrat e informatorëve (f. 309-312), si dhe

shpjegimi i simboleve të përdorura (f. 313-315) dhe harta të krahinës ku shtrihen FDS (f. 316-317).

Në fund të studimit jepet bibliografia e shfrytëzuar (f. 318-326).

FONOLOGJI – FONETIKË

Të folmet greke të krahinës së Delvinës dhe Sarandës kanë 29 fonema (/a/, /e/, /i/, /o/, /u/, /p/, /b/, /f/, /v/, /t/, /d/, /ts/, /dz/, /tʃ/, /dʒ/, /θ/, /ð/, /s/, /z/, /ʃ/, /ʒ/, /k/, /g/, /x/, /ɣ/, /l/, /r/, /m/, /n/), numër që ndryshon nga ai i fonemave të greqishtes së re (GR).

Në bazë të të dhënave akustike konstatohet se zanoret kanë një prirje për të qenë më të parme dhe pak më të hapura se zanoret e GR. Krahasuar me GR, në FDS nuk ka shumë ndërrime tingujsh.

Disa veçori fonetike që vërehen, kanë lidhje me *përbërjen fonematike të fjalëve*. Në këtë kategori veçoritë fonetike kufizohen mandej me qenien e dallimeve të lira tingullore etimologjike.

Tek zanoret e theksuara dallohen ndërrimet [i] : [e], [i] : [u], [e] : [o], [o] : [a]. Këtu vërehet një prirje e dobët drejt zanoreve të prapme ([i]→[u], [e]→[o]) dhe të hapura ([i]→[e], [o]→[a]).

Tek zanoret e patheksuara vërehen ndërrimet [o] : [u], [i] : [e], [i] : [e], [e] : [i], [i] : [u], [a] : [e], [u] : [e], [o] : [e], [e] : [a], [u] : [i], [u] : [o].

Prirjet kryesore të zanoreve të patheksuara janë: [o]:[u], [i]:[e], [e]:[i]. Megjithëse ndërrimet [o]:[u] dhe [e]:[i] zënë vendin e parë, nuk mund të flasim për mbizëtorim të të ashtuquajturave dukuri të «shurdhimit» të zanoreve në FDS. Shumica e ndërrimeve hasen në trup të fjalës dhe në pozicion paratheksor. Rrallë realizohen në zanore nistore. Ndërsa në pozicion fundor rregulli është i rreptë: nuk ka asnjë rast ndërrimi të zanoreve, qofshin këto të patheksuara apo të theksuara.

Nga një vështrim i thjeshtë i bashkëtingëlloreve konstatohet se të paktën katër prej tyre (/ʃ/, /ʒ/, /tʃ/, /dʒ/) mund të konsiderohen pastërtisht «dialektore». Fonemave të mësipërme u shtohen edhe realizimet e allofoneve [ʃ], [ʒ], [tʃ], [dʒ] të fonemave /s/, /z/, /ts/, /dz/ (që fonetikisht përkojnë me fonemat /ʃ/, /ʒ/, /tʃ/, /dʒ/), të cilat në mjedise të caktuara fonetike asnjansohen.

Veçori dalluese fonetike është edhe realizimi i fonemës /l/ si velare ([l]) dhe palatale ([ʎ]).

Edhe tek bashkëtingëlloret vërehen një numër ndryshimesh fonetike, megjithëse në një numër më të kufizuar fjalësh: /s/:/ts/ (e njohur si *citakizëm*), /x/:/k/, /x/:/ɣ/, /k/:/x/, /ɣ/:/x/, /ɣ/:/k/, /v/:/v/, /ð/:/l/, /l/:/ð/, /r/:/ð/, /v/:/ð/, /v/:/f/, /t/:/ð/, /ð/:/ɣ/, /ð/:/t/, /l/:/r/, /r/:/l/, /r/:/l/, /m/:/n/, /f/:/p/, /θ/:/f/.

Duke i trajtuar në kuadrin e fonetikës ndërsegmentale, autori përshkruan dhe analizon dukurinë karakteristike të krasitit për FDS [u] + [e] ⇒ [o], si dhe dukurinë e shtimit të zanores [a] në ballë të fjalës, ndërrimin [e] / [a] të zanoreve në pozicion nistor, si dhe bjerrjen e zanoreve të patheksuara nistore [a], [e], [i], [o].

Pjesa më e madhe e këtyre dukurive hasen edhe në të folme të tjera neogreke. Autori duke shfrytëzuar dhe interpretuar të dhënat dialektore nga FDS jep shpjegime të reja për dukuri të ndryshme, si f.v. për asimilimin e bashkëtingëlloreve qiellzore përpara zanores [i]. Ai vëren se është karakteri palatal i allofoneve [ç] dhe [j] dhe shqiptimi së bashku me zanoren [i], që e dobësojnë nyjëtimin e tyre në këtë mjedis fonetik dhe për këtë arsye asimilohen nga zanorja [i]. Një interpretim të ri jep edhe në rastin e rënies së bashkëtingëllores ndërzanore [s], duke shënuar se rënia e saj ndodh jo për shkak të pranisë së zanores [i], po është në të vërtetë disimilim në zero, për shkak të pranisë së bashkëtingëlloreve të njëjta ose të ngjashme në rrokje të njëpasnjëshme.

Në FDS ndodhin dukuri të tilla të pritshme për të folmet greke, si thjeshtimi i grupeve bashkëtingëllore apo ndërshtënia e disa bashkëtingëllore («zhvillimi i

bashkëtingëllores shoqëruese») në trup të fjalës apo e zanoreve midis grupeve bashkëtingëllore.

Si dukuri më karakteristike të fonetikës mbisegmentale të FDS autori vendos ngulitjen e theksit tek foljet. Kështu, tek FDS ndodh që fjala të theksohet në rrokjen e katërt nga fundi, një dukuri e pashembullt në gjithë historinë e greqishtes.

GRAMATIKË

Në kreun tretë shënohet se gramatika e FDS përbën një tërësi unike, ku hasen veçori të përgjithshme të të gjitha gjuhëve natyrore, veçori të përgjithshme të sistemit gramatikor të GR, veçori dialektore që hasen në një pjesë të madhe të të folmeve neogreke, si dhe veçori dialektore që hasen vetëm arealin e FDS.

Tabelat me paradigma lakimi dhe zgjedhimi janë shmangur. Vëmendja është përqendruar në një paraqitje metodike të sistemit gramatikor të të folmeve, nëpërmjet skematizimesh përmbledhëse, të cilat e japin më të qartë idenë e sistemit dhe të studimit të tij në planin strukturor.

Përsa i përket kategorisë së gjinisë, vërehet se ajo natyrore luan rol në ndërgjegjen e subjekteve folëse me pasojat përkatëse në përshtatjen gramatikore. Kështu, p.sh., ekziston një prirje e përgjithshme për përputhjen e gjinisë asnjansë gramatikore me gjininë mashkullore natyrore (*το γρούφι, derri, το τραί, çjapi, το σκυλί, qeni, το βόι, kau* etj.) Prirja për diferencimin e gjinisë natyrore mbështetet gramatikiht jo vetëm nga nyja, por edhe nga tregues të veçantë morfematikë. Janë karakteristike praspashtesat me të cilat formohen andronimet. Ndër to, prapashtesa -αιν- [en] është e njohur edhe në të folmet e tjera neogreke, -οβ- [ov] është me origjinë sillave, ndërsa -έσ- [eʃ] është me origjinë shqipe. Por veçoria kryesore gramatikore që karakterizon gjininë e FDS është prirja për interpretimin e mbaresës -ος si mashkullore.

Në kategorinë e numrit vërehet prirja e thjeshtimit dhe e specializimit të treguesve të tij. Mbaresa -οι, p.sh., është e specializuar për emrat mashkullorë, ndërsa mbaresa -ες kryesisht për femërorët. Si faktor kryesor për këtë zhvillim sillen mbiemrat, të cilët përcaktojnë emrat dhe zotërojnë një inventar të kufizuar morfemash.

Prirja e thjeshtimit, që karakterizon në përgjithësi FDS, shfaqet dukshëm tek kategoria e rasës. Veçoritë dialektore këtu lidhen si me format, ashtu edhe me përdorimet. Kallëzorja, shumë e dendur në përdorim, ofron disa raste të tilla. Në disa raste, përemra mashkullorë në kallëzore shfaqin një prirje për rrokje të hapur, duke u shtuar pas bashkëtingëllores karakteristike [n] një zanore [e] (*ποιόνε, αυτόνε, κα(ν)ένανε, ένανε*). Me të njëjtën mënyrë mbiemra dhe përemra emërzohen kontekstualisht (*Τέτοιο θάνατο έκαμε αυτός, παλλικαρίνονε. Το ντουινά όλονε είχε θρέψει η μανίτσα μου*).

Në disa emra që shënojnë kryesisht frymorë, sidomos emra shenjtorësh, vërehet formimi i trajtës së gjinore sipas gjedhes së lashtë, me lëvizje të theksit në rrokjen fundore (*αντρός, γυναικός, κοπελός, πατερός, φοραδός, προβατινός, Αβασιλιού, Αθανασού, Αντριγιός*).

Gjinorja njëjës e disa përemrave formohet sipas gjedhes së kallëzores, me pjesëmarrjen e bashkëtingëllores [n] në morfemën e gjinore dhe me shtimin e një rrokjeje më shumë (*ποιόνου, ποιάνης, κάποιο(υ)νου, κάποιανης, αυτουνού, αυτηής, τουτουνού, τουτηνης, κα(ν)ενού, καμμιανης, ενανού, μιανής* etj.)

Në gjinoren shumëës është një dukuri e zakonshme shtimi e zanores [e] pas mbaresës -ών, d.m.th. -ώνε.

Tek emrat e përveçëm familjarë vërehet prirja drejt rasës emërore, si më shprehëse. Kjo gjë e vështirëson shpeshherë dallimin e emrit të parë nga emri familjar. Në një seri toponimesh emri, që dikur shfaqej në rasën gjinore, tani përdoret në emërore (khs. *το Μεμούσμπει < του Μεμούσμπη κ.λπ.*)

Përsa u përket foljeve, në vështrim formal konstatohet kjo karakteristike e përgjithshme: inventari i morfemave është i njëjtë si në FDS ashtu edhe në GR, por

ndryshon shpërndarja e tyre dhe kjo ndodh prej trysnisë së disa trajtave më të dendura. Kategoria më e përhapur janë foljet më *-άω* [ˈao], *-άζω* [ˈazo] dhe *-ίζω* [ˈizo], por edhe më *-έω* [ˈevo]). Vërehet allomorfizim i morfemave në një sërë foljesh (përdoren më shumë se një mbaresë foljore për të njëjtën folje).

Tek foljet e trajtës joveprore vërehet përdorimi i allomorfeve në varësi të vendit të theksit. Kur theksi bie në rrokjen tejfundore, përdoret allomorfi *-ομαι* [me]. Kur theksi bie në rrokjen parafundore, përdoret allomorfi *-ίμαι* [ˈime] dhe më rrallë *-ίομαι* [ˈioɱe] dhe *-άμαι* [ˈame].

Në FDS, ashtu si në GR, përdoren dallohen katër mënyra: dëftore, lidhore, urdhërore dhe pjesore. Çka ndryshon lidhet me inventarin e kohëve, me formimin e tyre, si dhe me mënyrën e shfaqjes së aspektit foljor. Mungesa e formave «hamendësore» dhe «mundësore» i detyrohet ndikimit të shqipës.

Tema e së tashmes dëftore shërben si bazë e formimit të kohëve dhe mënyrave të tjera. Vetëm në disa raste të rralla tema e së tashmes formohet mbi bazën e temës së kryer të thjeshtë (khs. *έρθωμαι*, *vij*, ku *ερθ-* është në thelb tema e kohës së kryer të thjeshtë: *έρθα*, *έρθεις*...).

Si veçori kryesore dialektore në kohën e tashme të dëftores janë: a) përdorimi i rregullt i formës pa kontraksion, ku realizohet mbaresa më *-άω* [ˈao] dhe b) realizimi i mbaresës së v. I shumë pa mbylljen e zanores [o], d.m.th. morfema realizohet rregullisht *-ομε* [ome] dhe jo *-ουμε* [ume].

Në të pakryerën josigmatike përdoren disa trajta karakteristike (*ήβλεπα* / *ήγλεπα*, *έβρισκα* / *ήβρισκα*, *ήλεγα*, *έπαιρα* etj.) E pakryera sigmatike formohet me folje të zgjedhimit të dytë, duke u shtuar mbaresa që kanë bashkëtingëlloren *-σ* [s]. Nën trysninë e së kryerës së thjeshtë shtesa (fonetike) e së pakryerës realizohet si *η-* [i] (*ήλεγα*, *ήβρισκα*, *ήγλεπα*, *ήκουα*). Në shumë raste të tjera përdoret *pseudaugmenti* fonetik *ε-* [e], të cilin autori e emërton kështu, pasi përdoret në disa kushte të caktuara fonetike, është i paqëndrueshëm dhe nuk theksohet. Si dukuri ligjërimore, *pseudaugmenti* fonetik [e] përdoret për të përmbushur një nevojë estetike të folësve për një të ligjëratë më të bukur. *Pseudaugmenti* fonetik [e] përdoret pa dallim tek foljet e dy zgjedhimeve, sigurisht nën ndikimin e shtesës së vërtetë. Trajta të së pakryerës më *-γ-* [ɣ] përdoren më shumë në pjesën lindore dhe verilindore të të folmeve (Grazhdan, Zminec, Kardhikaq etj.), ku hasen gjithashtu edhe trajta të shumësit më *-αμαν* [aman], *-αταν* [atan]. Si dukuri morfonologjike kryesore përmendet prirja për ngulitjen të theksit, i cili shfaqet gjatë gjithë paradigmes mbi një bashkëtingëllore të caktuar, bile edhe në rrokjen e katërt nga fundi (khs. *έπαιραμε*, *έπαιρατε*, *έπαιρανε*). Në rastet kur para trajtave të së pakryerës veprime përdoret një trajtë e shkurtër e përemrit vetor, theksi bartet tek trajta e shkurtër (khs. *τό παираμε* [ˈtoɱame], *τά μαθαμε* [ˈtamaθame], *τό λεγανε Βενιαμίν* [ˈtoɱane]).

Në varësi të mënyrës së formimit të së kryerës së thjeshtë, autori dallon dy klasa të saj: a) sigmatike dhe b) josigmatike, e cila ndahet mandej në tri nënklasa b₁) josigmatike perfekte (për formimin e saj përdoret bashkëtingëlloret *-κ-* [k]), b₂) josigmatike joperfekte (tipi i njohur edhe në përgjithësi në GR) dhe b₃) supletive (disa trajta foljesh të parregullta). Disa folje shfrytëzojnë dy apo edhe tri tema allomorfe për realizimin e së kryerës së thjeshtë (khs. *πηγ-* dhe *παησ-*, *αρχισ-* (ose *αρχινισ-*) dhe *αρχεψ-*, *εδωκ-* dhe *εδεικ-*, (*α*)*πομειν-* dhe (*α*)*πομεικ-*).

Për formimin e temës së të kryerës së thjeshtë përdoren edhe këto mjete: a) bartja e theksit në rrokjen e mëparshme (ashtu si tek e pakryera); b) augmenti fonetik *ε* [e] (*εκαμ-*, *εφαγ-*, *επι-*) ose *η* [i] (*ηφερ-*, *ηκουσ-*); c) ndërrime morfonologjike (*διν-*: *εδωκ-*, *και-*: *εκαψ-*).

Në pjesën lindore dhe verilindore të FDS hasen edhe trajta të shumësit me mbaresat *-αμαν* [aman], *-αταν* [atan], të cilat përdoren edhe në të pakryerën. Ashtu si në të pakryerën, edhe këtu theksi mbetet i ngulitur dhe haset, gjithashtu, përdorimi i dendur i *pseudaugmentit* fonetik.

Mjetet për formimin e kohëve të përbëra janë a) pjesëzat *va, aς, (θ)α* dhe b) foljet ndihmëse *έχω, είμαι*. Këtu vërehet qartë një prirje gramatikalizimi (ose pjesëzorizimi apo ngurtësimi) të foljeve ndihmëse.

Në shumicën e rasteve e kryera me foljen *έχω* + «*paskajore*» nën ndikimin e shqipes përdoret në vend të më se të kryerës. Krahas saj, përdoret e dhe një ndërtime tjetër dialektor, i përbërë nga folja ndihmëse e ngurtësuar *έχει* dhe nga tema e së kryerës së thjeshtë veprorë, së cilës i ngjiten mbaresat e e kohës së tashme, që në mënyrë skematike paraqitet kështu:

[έχει] → [tema e së kryerës së thjeshtë veprorë] ← [-ω, -εις, -ει, -ομε, -ετε, -ου]

Formimi i së kryerës së thjeshtë dhe i më se të kryerës me foljen ndihmëse të ngurtësuar *έχει/είχε* përbën veçorinë kryesore dialektore të FDS, që nuk haset në asnjë të folme tjetër neogreke. Në këtë vështrim, FDS mund të emërtoheshin ndryshe edhe të folmet e foljes ndihmëse të ngurtësuar.

E kryera e thjeshtë dhe më se e kryera pësore ndjekin të njëjtën gjedhe formimi si përkateset veprorë.

Dëftorja njih këto kohë të ardhme: të vazhduarën, të çastit, të përparmen dhe të përparmen e së kryerës. Në përgjithësi nuk ndryshojnë formalisht nga përkateset e GR, por edhe këtu nuk mungojnë raste përdorimesh dialektore. Në disa folje, p.sh., e ardhmja formohet duke pasur për bazë formën e lidhores me pjesëzën *va* (p.sh., [θ]α *va* *χω*).

Koha e ardhme e përparme formohet me dy mënyra: njëra si në GR (forma e së kryerës e prirë nga pjesëza *θα* [do]), ndërsa tjetra, që përbën edhe dukuri dialektore, me formën dialektore të më se të kryerës, së cilës i prin *θα* [do] (p.sh. *θα χε δουλέψω, θα χε δουλέψεις, θα χε δουλέψει, θα χε δουλέψομε, θα χε δουλέψετε, θα χε δουλέψουν(ε)*).

Të njëtat vërejtje mund të bëhen edhe për formimin e kohëve të lidhores, ku në vend të pjesëzës *θα* [do] përdoret pjesëza *va* [të].

Mënyra urdhërore ka si veçori kryesore mungesën e kohës së tashme në formën pohuese, ku përdoret vetëm e kryera e thjeshtë, dhe mungesën e kohës së kryer të thjeshtë në formën mohuese, me vlerën e së cilës përdoret e tashmja.

Tek mbiemrat vërehet si një dukuri e rëndomtë formimi i mënyrës krahasore duke përdorur njëkohësisht mjete sintetike dhe analitike (khs. *πιο χειρότερο, πλιο καλύτερα* etj.). Ndikimi i formave *καλύτερος* (më i mirë) dhe *χειρότερος* (më i keq) vetëm në disa raste të pakta ka favorizuar krijimin e formave amalgamë të shkallës krahasore.

Në FDS përdoret, ashtu si në shqipe, edhe krahasorja metaforike, një tregues i konkretësisë prej së cilës përshkohen të folmet dialektore. P.sh., *άσπρος φλόγα, κρύος μπουζί, μαύρος σκαρλί, ζεστόύτσικος θάμα, τζούλιο μακρύς*.

Tek përemrat përmenden si veçori dialektore karakteristike sidomos ndarja e funksioneve tek dëftorët e mirëfilltë, ku *τούτος, -η, -ο* përdoret për sende/frymorë që gjenden afër folësve, *αυτός, -ή, -ό* përdoret për sende/frymorë që nuk gjenden afër folësve, por mund të gjenden afër bashkëfolësve, ndërsa *εκείνος, -η, -ο* përdoret për sende/frymorë që gjenden larg bashkëfolësve. Për të theksuar dëftueshmërinë në shumë raste përdoret pjesëza *για*, që u prapashtohet përemrave dëftorë (p.sh., *αυτός-για, αυτή-για, αυτό-για*).

Sintaksa e FDS karakterizohet nga prirja për konkretësi, e cila ndikon edhe në formësimin e ligjëritimit dialektor (fjali të shkurtra, përdorim i dendur i foljeve, i formave apo modaliteteve të njëjta gramatikore, përdorime të shpeshta pasthirrmash me vlerë kallëzuesie, ku ndërhyjnë zakonisht edhe faktorë jashtëgjuhësorë, si gjestet, pjesëmarrja e pjesëve të ndryshme të trupit në nyje të caktuara të ligjëritimit, ndryshimi i rendit të fjalëve dhe rrjedhimisht edhe i fokusimit, përdorimi i pakët i ndërtimeve pësore, epërsia e sintaksës bashkërenditëse në dëm të asaj nënrenditëse, përsëritja e të njëjtëve tregues gramatikorë në disa segmente të zinxhirit ligjëritimor).

FJALËFORMIMI

Tek fjalëformimi vërehet një numër i kufizuar morfemash me karakter të ngushtë dialektor.

Si dukuri që spikat më shumë është formimi i gjinive të mbiemrit me elementin prapashtesor *-ik-* [ik]; khs. *κούτσικος* : *κούτσικη* : *κούτσικο* (*i/e vockël*); këtu veçoria dialektore nuk është prania e prapashtesës *-ik-* në të tria gjinitë, por prania e saj vetëm në gjininë asnjane. Në një pjesë tjetër formimesh ndërhyjnë etimologjia popullore.

STRUKTURA LEKSIKORE

Në fjalorin e FDS vërehet prania e fjalëve me origjinë të lashtë e mesjetare (*αγκινάρα, αγάλια, αλουπού, απίδι, δίβουλος, κατόπι, ξόγανο, παραχώνω, πιλάλα, πύρια, πυρώνω, ρουπίζω, ρουτί* etj.), por edhe i huazimeve. Ndryshime në leksik vërehen edhe brendapërbrenda arealit të FDS. Vërehen ndryshime në përzgjedhje leksemash në Vurg dhe në Theollogo, nga të dyja anët e Bisticës, dhe në përgjithësi ka dallime midis zonave malore dhe atyre fushore. Dallime ka edhe brendapërbrenda një vendbanimi.

Një pjesë e punimit i kushtohet ndikimit të gjuhës shqipe në FDS. Bashkëjetesa e gjatë midish grekëve dhe shqiptarëve të krahinës krijoi premisa për zhvillimin e dygjuhësisë në disa vendbanime siç është, p.sh., Muzina. Nga shqyrtimi i të dhënave dialektore konstatohet bashkëjetesa shekullore e greqishtfolësve me shqipfolësit e krahinës. Në marrëdhëniet e shqipes me greqishten në trevën më të gjerë ndikimi i nëndialektit lab mbi FDS është më i fuqishëm sesa ndikimi i nëndialektit çam. Sot gjuha shqipe ushtron autoritetin e gjuhës zyrtare, e cila zbatohet në shkollë dhe në media. Gjuha shqipe zë vendin e parë ndër gjuhët që ndikuan më shumë FDS. Ka rreth 400 leksema me prejardhje shqipe. Një pjesë më e vjetër huazimesh shqipe nuk ndihen si të huaja, pasi ato janë bërë pjesë e ligjërit të përditshëm (*αρέντα, βέρδα, βιτόρα, βλάμης, γκιόλι, γκλάκα, γκριντάλω, γκρόπα, γκρούκα, καστεκόκι, καλιγέτσι, κιαϊμιλιώ, μελιγκούνι, μότριμα, μούζγκος, μπάλα, μπίστα, μπουκουβάλα, μπούρας, μπρούσα, ντερζί, πέγκα, πό, φλετουράω, φουρτέλια* etj.). Ndryshimet fonetike që ato kanë pësuar janë të rëndësishme. P.sh., huazimi *κορομάνα* vjen nga shq. *koromar/e ~a*, por sot në shqipe haset me rotacizëm (*koromar/e ~ja*). Disa leksema me prejardhje shqipe sot nuk përdoren as në këtë gjuhë, ose janë objekt përzgjedhjeje për zona të tjera dialektore (*μότριμα* (shq. *motër/m/ë ~a*), *ζόνια* (shq. *zonj/ë ~a*)). Me një pjesë leksemash me prejardhje shqipe folësit e FDS kanë formuar fjalë të tjera, që nuk ekzistojnë në shqipe (*αρεντεύω, αφίσικος, γκορδαλεύω* etj.) Gjuha e fëmijëve karakterizohet nga prania e shumë fjalëve me burim nga shqipja.

Në punim bëhen vërejtje edhe për përdorimin stilistikor të fjalëve në FDS, ku dallohen disa stile: a) stili neutral b) stili i ulët dhe c) stili i lartë. Preken gjithashtu edhe dukuri të tilla, si polisemia, sinonimia, homonimia, antonimia, ndërrimi / zgjerimi / kufizimi i kuptimit, kalket leksikore, përdorimet argotike. Vërehet në përgjithësi një karakter konservativ në shumë elemente.

PËRFUNDIME

FDS karakterizohen gjeografikisht si të folme veriore, ndërsa fonetikut si jugore. Në morfologji karakterizohet nga prirje të dukshme thjeshtimi, ndërsa në sintaksë ndikimi i strukturave shqipe është shumë i fuqishëm.

Gjendja e sotme e FDS karakterizohet nga restriksioni, nga kontaktet e përditshme të popullsisë aktive me GR, për shkak të emigrimit të mijëra folësve aktivë nëpër qendrat e mëdha urbane të Greqisë. Tek folësit e rritur format dialektore tërhiqen, si shoqërisht të papranueshme. Brezi i ri, që rritet në Greqi, po i humbet gradualisht lidhjet me vendlindjen, duke mbetur pa kontakt me ligjërimin dialektor. Ndërkohë, në arealin e FDS sot kanë mbetur kryesisht individë të moshës

së thyer. Kështu, krijohet një hendek komunikativ midis brezave, duke ruajtur secili një pozicion të ndryshëm në diasistemin e GR.